



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Nr. 2073/Prot.
11

Tiranë, më 8.4.2021

U D H Ë Z I M

Nr. 7, datë 8.4.2021

**PËR
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR DHËNIEN E
MEDALJES SË ARTË NXËNËSVE TË SHKËLQYER NË VITE, PAS
PËRFUNDIMIT TË ARSIMIT TË MESËM TË LARTË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

U D H Ë Z O J:

**KREU 1
KRITERET PËR PËRFITIMIN E MEDALJES SË ARTË**

1. Nxënësit të shkëlqyer ndër vite, pas përfundimit të arsimit të mesëm të lartë, i jepet "Medalje e artë", nëse plotëson njëherësh kriteret e mëposhtme:
 - a) Ka përfunduar arsimin e mesëm të lartë me notë mesatare 10.00.
 - b) Në secilin prej provimeve kombëtare të detyruara të Maturës Shtetërore (MSh) është vlerësuar me jo më pak se nota e shkallëzuar 9.50.
 - c) Në provimin kombëtar me zgjedhje të MSh është vlerësuar me jo më pak se nota e shkallëzuar 10.00.
 - d) Ka vlerësimin në sjellje "Shumë mirë", në gjitha vitet e arsimit të mesëm të lartë.
2. Nderohet me "Medalje e artë" nxënësi që është fitues i njërit prej tri çmimeve të para në olimpiadat ndërkombëtare me më shumë se 15 vende pjesëmarrëse, sipas Rregullores "Për zhvillimin e olimpiadave kombëtare në arsimin parauniversitar dhe pjesëmarrja e nxënësve në olimpiadat ndërkombëtare".

KREU 2

PROCEDURA PËR DHËNIEN E “MEDALJES SË ARTË”

1. Në javën e parë të vitit shkollor institucionet arsimore parauniversitare përgatitin dhe dërgojnë në zyrat vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP), listat dhe dosjet e nxënësve që plotësojnë kriteret për “Medalje e artë” sipas kreut 1 të këtij udhëzimi.
2. Dosja e nxënësit përmban dokumentet e mëposhtme:
 - a) fotokopjen e kartës së identitetit;
 - b) fotokopjen e diplomës dhe certifikatës së MSh;
 - c) vlerësimin për sjelljen, për të gjitha vitet e arsimit të mesëm të lartë, lëshuar nga drejtorja e institucionit arsimor parauniversitar.
 - d) fotokopjen të certifikatës që nxënësi ka fituar sipas pikës 2, të kreut 1, të këtij udhëzimi nëse ai e disponon.
3. ZVAP-et nëpërmjet drejtorive rajonale të arsimit parauniversitar (DRAP), përcjellin brenda një jave listat dhe dosjet e nxënësve në Drejtorinë e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP).
4. DPAP-ja dërgon në Qendrën e Shërbimeve Arsimore (QSHA), listën e nxënësve të propozuar për “Medalje e artë”, e cila pasi kryen verifikimet për secilin nxënës lidhur me notën mesatare të shkollës së mesme, notën e shkallëzuar të provimeve të detyruara dhe të provimit me zgjedhje, si dhe certifikatën që nxënësi ka fituar në olimpiadën ndërkombëtare, e përcjell atë brenda një jave në DPAP.
5. DPAP, përcjell në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), dosjet e nxënësve së bashku me listën e verifikuar nga QSHA.
6. MASR-ja, pasi bën verifikimin përfundimtar të dosjes për secilin nxënës, sipas kriterëve dhe procedurave të këtij udhëzimi, përcjell në Kryeministri listën e nxënësve që u jepet “Medalje e artë”, të shoqëruar me projekturdrin dhe relacionin shoqërues.

KREU 3

DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. MASR ka detyrimin të prodhojë “Medalje e artë” për të gjithë nxënësit që i përfitojnë ato.
2. Nxënësi, i cili pajiset me “Medalje e artë”, nuk ka përfitime të tjera financiare.
3. MASR mban në një regjistër të veçantë të dhënat e nxënësve, të cilët janë pajisur me medaljen e artë.
4. Udhëzimi nr. 21, datë 02.08.2013, “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për dhënie të Medaljes së artë”, i ndryshuar, shfuqizohet.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtorja e Përgjithshme e

Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet e arsimit parauniversitar.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

Evis KUSHI

